



KONFERENCA E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS MBI "STANDARDET PËR KOSOVËN" MBAJTUR NË OHËR ME 29 E 30 KORRIK

Komunat e Kosovës kanë pasur përparim dhe janë pikë kyçe në përmbushjen e standardeve për Kosovën



Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të përgjegjësisë që mund të inkorporohen si fusha që duhet të përmbushen nga komunat në kuadër të dokumentit "Standardet për Kosovën" dhe me mbështetjen e KFOS, IFES Ltd. e ADL-ja, kanë organizuar Konferencën dyditore me kryetarët e komunave dhe faktorët relevant. Konferenca ka synuar përgatitjet për një "vlerësim paraprak" të pozitës aktuale të komunave në lidhje me agjendën e "Standardet për Kosovën" duke debatuar së bashku kryetarët e komunave, përfaqësuesit e Kolegjit të Kryeshefave Ekzekutiv, dhe një sërë partnerësh ndërkombëtar, për të ndërmarrë veprime. Në Konferencën dyditore morën pjesë 22 kryetarë të komunave të Kosovës dhe dy kryeshefa ekzekutiv si përfaqësues të partive më të mëdha politike të shqiptarëve dhe përfaqësues të serbëve të Kosovës. Poashtu në Konferencë kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesë nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Shërbimeve Publike, UNMIK-u (Zyra e PSSP-së), UNDP, OSBE, dhe IFES Ltd.

Në hapje të konferencës, z.Lufti Haziri kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe kryetar i komunës së Gjilanit, duke bërë prezantimin e programit tha se gjatë kësaj konference do të diskutojmë për standardet nga këndi i komunave të cilat janë pjesë përbërëse e standardeve. Ne si AKK kemi realizuar një program i cili ka hulumtuar çështjen e standardeve nëpër komuna dhe kemi vërtetuar se disa nga komunat kanë realizuar disa nga standardet brenda mundësive dhe kompetencave që kanë. Në fjalën e tij z.Zenun Pajaziti, këshilltar për standarde pranë Qeverisë së Kosovës ndër të tjera tha se unë kam ardhur këtu në emër të Qeverisë së Kosovës që t'iu mbështesim juve komunave për

realizimin e standardeve. Ai më tutje tha se komunat kanë një rol të madh në realizimin e standardeve e sidomos sa i përket standardit për kthim, mirëpo duhet që të gjenden rrugët apo mekanizmat për të implementuar standardet, prandaj le të na shërbej ky takim për ta sqaruar rolin e secilit e sidomos të komunave në implementimin e standardeve.

Gjatë dy ditëve sa ka zgjatur Konferenca, në të cilën është debatuar veç e veç për secilin nga tetë standardet, kanë diskutuar pothuaj të gjithë të pranishmit që herë-herë debatet zhvilloheshin në bashkëbisedim për të gjetur mundësitë më të mira për realizimin e standardeve nga këndi i pushtetit lokal në Kosovë.

Në fund të Konferencës dyditore janë nxjerr disa përfundime. Në një, se komunat dëshirojnë të rishikojnë dhe shtyjnë vlerësimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me përmbushjen e standardeve dhe për këtë mirëpresin mbështetjen e donatorëve në kryerjen e hulumtimit për standardet dhe realizimin e tyre. E dyta, komunat besojnë se kanë pasur përparim të konsiderueshëm dhe se janë pikë kyçe në arritjen e përmbushjes së standardeve; ata dëshirojnë të afirmojnë arritjet e tyre në këtë drejtim. Propozohet të ngrihet një mekanizëm i rregullt raportimi; dhe përveç raportimit formal nëpërmjet Ministrisë, AKK-ja luan rol në ofrimin e informacionit të vazhdueshëm për përfaqësuesit e komunave në komisionin e implementimit të standardeve. Dhe konkluzioni i tretë i Konferencës së Ohrit thekson se Asociacioni i Komunave të Kosovës dëshiron të zgjerojë aktivitetin e tij me donatorë në mënyrë që të stimulojë zhvillimin ekonomik, i cili është një faktor i rëndësishëm dhe pozitiv për kushtet e jetesës së qytetarëve të Kosovës.

AKK-ja caktoi përfaqësuesit për grupet punuese në "Standardet për Kosovën"

Udhëheqësit e AKK-së morën pjesë në Konferencën vjetore të qeverive lokale që u mbajt në Britani të Madhe

Delegacionet e AKK-së u pritën në takime zyrtare në ShBA dhe në Suedi

Asociacioni i Komunave merr pjesë në hartimin e Kornizës për Reformimin e Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë

Asociacioni i Komunave dhe Ministria e Transportit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

Përfaqësuesit e AKK-së morën pjesë në takimin e NALAS-it në Slloveni

Gjashtë komuna janë përzgjedhur nga USAID-i në programin për përforcimin e aftësive të qeverisjes lokale

Demokracia më së miri vendoset në pushtetin lokal - u tha në trevjetorin e AKK-së

Udhëheqësit e AKK-së morën pjesë në Konferencën vjetore të qeverive lokale që u mbajt në Britani të Madhe



Asociacioni i Komunave të Kosovës i përfaqësuar nga kryetari z.Lufti Haziri dhe drejtori ekzekutiv z.Sazan Ibrahim i morën pjesën në Konferencën Vjetore të 2004 "Ndryshimet: Shërbimet publike lokale" që u organizua nga Asociacioni i Qeverive Lokale të Anglisë dhe Uellsit. Konferenca trajtoi temat si "E ardhmja e Qeverive Lokale", "Raporti këshilltar-qytetar-konsumator-votues", "Strategjitet Lokale – prioritetet kombëtare", "Pamja e rrugëve – transformimi i planit urban lokal" etj. derisa përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave kanë marrë pjesë intensive në këtë konferencë duke pasqyruar sukseset dhe sidat e pushtetit lokal në Kosovë. Udhëheqësit e Asociacionit të Komunave të Kosovës vizituan edhe komunën e Arun-it ku u takuan me zyrtarë të lartë të kësaj komune dhe shkëmbyen përvojat në vetëqeverisjen lokale si dhe patën takime të rëndësishme me udhëheqësit e Byrosë Ndërkombëtare të Autoriteteve Lokale të Anglisë (LGIB).

Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës u pritën në takime zyrtare në ShBA dhe në Suedi

Nënkryetari i AKK-së dhe kryetari i komunës së Skenderajit z.Ramadan Gashi ishte për vizitë në SHBA. Z.Gashi pati takime të ndryshme siç ishte takimi me Drejtorin e Ligës së Komunave në Lister City, mandej me përfaqësuesit e komunës së Denevillit etj. Gjatë këtyre takimeve nënkryetari i AKK-së z.Ramadan Gashi ka bërë prezentimin e punës dhe aktiviteteve AKK-së. Përgjithësisht z.Gashi është bërë një pritje e jashtëzakonshme me një publicitet të madh. Poashtu z.Gashi ka vizituar fabrika të ndryshme dhe Klubin e Mjekëve të cilët kanë bërë një operim të një djaloshi nga Skenderaj, ku edhe mjekët janë pajtuar që kjo të bëhet edhe në të ardhmen meqë është shumë e rëndësishme.

Ndërsa gjatë vizitës së tij në Suedi, anëtari i Bordit të AKK-së dhe kryetari i komunës së Shtimës z.Fehmi Mujota ka pasur takime të ndryshme si me përfaqësuesit e Lidhjes së Komunave të Krono Bergut. Kryetari Mujota tha se një delegacion nga Suedia, përkatësisht nga Lidhja e Komunave të Krono Bergut do ta vizitoj Kosovën më 25 tetor deri më 10 nëntor.



Asociacioni i Komunave caktoi përfaqësuesit për grupet punuese në "Standardet për Kosovën"



Në mbledhjen e rregullt të Bordit të AKK-së mbajtur më 24/07/2004 u bë emërimi i përfaqësuesve të AKK-së të cilët do të marrin pjesë në grupet punuese "Standardet për Kosovën".

1. Institucionet e vetëqeverisjes
2. Sundimi i ligjit
3. Liria e lëvizjes dhe përdorimi i lirë i gjuhës
4. Kthimi
5. Ekonomia
6. Të drejtat pronësore juridike
7. Dialogu
8. TMK

Ismet Beqiri
Ramadan Gashi
Mursel Ibrahim
Lufti Haziri
Fadil Ferati
Adem Salihaj
Fehmi Mujota
Ismet Beqiri

Asociacioni i Komunave merr pjesë në hartimin e Kornizës për Reformimin e Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë

Grupi i punës për Qeverisjen Lokale i bashkëkryesuar nga Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes dhe UNMIK-u dhe i përbërë nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, **Asociacioni i Komunave të Kosovës**, Ministria e Shërbimeve Publike, UNMIK-u, përfaqësues të Komuniteteve dhe ekspertë ndërkombëtar nga USAID-i, Këshilli i Evropës, OSBE-ja është krijuar me qëllim të përgatitjes së një kornizë për reformimin e vetëqeverisjes lokale. Grupi i punës është krijuar në kontekstin e kërkesës së bërë në Deklaratën Presidenciale të Këshillit të Sigurimit të datës 30 prill 2004 për "qeverisje lokale më efektive ndërmjet devoluimit tek autoritetet lokale të përgjegjësive qendrore jo të rezervuara" dhe ftesës së bërë palëve të interesuara në Kosovë për të zhvilluar propozime konkrete për reformën.

Asociacioni i Komunave dhe Ministria e Transportit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

Me qëllim të ruajtjes, rregullimit dhe në mënyrë që ti jepet shtytje zhvillimit të stacioneve të autobusëve, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit kanë lidhur një marrëveshje për të përcaktuar veprimin e përbashkët të MTPT-së dhe komunave të Kosovës.

Në marrëveshje ndër të tjera thuhet se komunat dhe MTPT-ja pajtohen që stacionet e autobusëve janë e mirë publike dhe është e domosdoshme ekzistenca dhe funksionimi i tyre. Me marrëveshje përcaktohet që komuna do të merr përgjegjësinë për menaxhimin e stacionit të autobusëve ndërsa MTPT-ja do të përkujdeset për mbarëvajtjen dhe respektimin e ligjeve dhe akteve tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e stacionit si dhe operimit për transport ndërrurban dhe ndërkombëtar.

AKK-ja dhe MTPT-ja janë pajtuar që të kërkohet nga AKM-ja që në politikat e saja operationale të privatizimit, stacionet e autobusëve të ndahen nga operimet e transportit dhe mirëmbajtjes dhe stacionet e autobusëve të mos i nënshtrohen procesit të privatizimit. Poashtu AKK-ja dhe MTPT-ja janë pajtuar që të themelohet Autoriteti Rregullativ i stacioneve të autobusëve i cili do të përcaktohet me një akt të veçantë të MTPT-së në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës si dhe bazuar në këtë marrëveshje dhe ligjeve në fuqi MTPT-ja do të nxjerr rregullore të veçanta mbi funksionimin e stacioneve të autobusëve. Marrëveshja është nënshkruar nga kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Lutfi Haziri dhe Sekretari i Përhershëm në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit z.Gëzim Pula.

Delegacioni i AKK-së mori pjesë në Konferencën e NALAS-it në Slloveni



Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës i kryesuar nga z.Fadil Ferati kryetar i Komisionit për Financa në AKK dhe kryetar i komunës së Istogut së bashku me z.Halim Shemsedini Kryetar i Komunës së Dragashit e z.Arsim Osmani Menaxher për Komunikim në AKK morën pjesë në takimin punues ndërkombëtar me temën Roli i Asociacioneve të Qeverisë Lokale, menaxhimi i financave publike në nivelin lokal në Evropën Juglindore.

Takimi që u mbajt në Bled të Sllovenisë për dy ditë më rradhë ishte organizuar në mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Iniciativa për Reforma në Qeverisje Lokale dhe Shërbime Publike e Institutit për Shoqëri të Hapur - Budapest, USAID dhe Asociacioni i Komunave dhe Rretheve të Sllovenisë.

Gjatë këtyre dy ditëve është debatuar për Rolin e Asociacioneve të Qeverive Lokale në ngritjen e kapaciteteve dhe në ofrimin e shërbimeve si dhe vlerësimi i nevojave dhe mundësive për punën e Asociacioneve të Qeverive Lokale në Evropën Jug-Lindore dhe menaxhimin e financave në nivel lokal.

Delegacioni kosovar ka marrë pjesë në të gjitha seancat duke dhënë kontributin e tij dhe duke njoftuar të pranishmit për funksionimin e pushtetit lokal, punën e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe menaxhimin e financave publike nga pushteti lokal.

SHBA-të ndihmojnë komunat në ngritjen e cilësisë së shërbimeve komunale

"Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmes USAID-it do të punojë së bashku me të gjitha qeveritë komunale të Kosovës në ngritjen e cilësisë së shërbimeve komunale, të cilat iu ofrohen qytetarëve, duke angazhuar kuadro, si këshilltar dhe konsulent etj. për menaxhim komunal" – kështu tha drejtori i ri i USAID-it, Ken Jakashita me rastin e prezantimit të projektit "Iniciativa për Qeverisjen Lokale". "USAID-i ,edhe gjatë mandatit tim trevjeçar në Kosovë, do të vazhdojë mbështetjen e institucioneve të Kosovës me programe të ndryshme ndërsa zbatimi i kësaj përkrahje do të ndryshojë, ka thënë drejtori i ri i USAID-it duke folur për mënyrën e realizimit të projekteve.

Drejtori ekzekutiv i AKK-së z. Sazan Ibrahim, ka thënë se qëllimi i këtij projekti është rritja e transparencës së komunave ndaj qytetarëve dhe zhvillimi ekonomik lokal". Kristofer Kaçnarski, përfaqësues i projektit, tha se edhe pse do të ketë përzgjedhje të disa komunave, të gjitha komunat e Kosovës do të kenë qasje në ndihmën që do të ofrohet nga këto ekiye.

Gjashtë komuna janë përzgjedhur nga USAID-i në programin për përforcimin e aftësive të qeverisjes lokale

Gjashtë komuna, Gjakova, Gjilani, Peja, Podujeva, Shtërpca dhe Suhareka – janë përzgjedhur nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) si qendra që do të jenë nikoqire të këshilltarëve që do të punojnë me administratën e qeverisë lokale në programin për përforcimin e aftësive të qeverive lokale në kryerjen e punëve të tyre dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Pjesëmarrja e këtyre komunave si nikoqirë të Iniciativës së USAID-it për Qeverinë Lokale do t'i nënshtrohet nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit në mes komunës nikoqire dhe USAID-it e në të cilin do të jipen kushtet e pjesëmarrjes.

"Këto komuna, nëpërmes aplikimit të tyre dhe intervistimit nga ana e ekspertëve të projektit, kanë demonstruar një interes të jashtëzakonshëm për të mirëpritur këshilltarët dhe një gatishmëri për të përmirësuar funksionimin e administratës së tyre", ka

theksuar dr. Ken Jamashita, drejtor i Misionit të USAID-it në Kosovë.

"Përveç kësaj, Iniciativa e Qeverisë Lokale do të përdorë këto komuna si seli regjionale nga ku do të shpërndahen informatat dhe përvoja tek të gjitha komunat në Kosovë. Qeveria lokale ofron kontaktin më të drejtpërdrejtë me të gjithë njerëzit e Kosovës kështu që ne besojmë se ky program do të ndihmojë në zhvillimin e përgjigjes së komunave ndaj nevojave të tyre". Iniciativa për Qeverinë Lokale (IQL), e mbështetur nga Qeveria e SHBA-ve nëpërmes USAID-it, është një program i ri trevjeçar për përmirësimin e efektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së qeverive lokale në Kosovë.

Iniciativa do të përqëndrohet në përmirësimin e menaxhimit komunal dhe udhëheqësisë, nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe shtimin e pjesëmarrjes publike në qeverisjen lokale.

United States Agency for
International Development - Kosovo

Building a democratic, economically sustainable Kosovo,
with equal opportunities and rights for all its citizens.



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS SHËNOI TRE VJETORIN E THEMELIT DHE TË AKTIVITETEVE

Demokracia më së miri vendoset në pushtetin lokal

Asociacioni i Komunave të Kosovës shënoi 3 vjetorin e themelimit në një solemnitet rasti e ku merrnin pjesë kryetarë e kryeshefa ekzekutiv të komunave të Kosovës, përfaqësues të institucioneve qendrore të vendit e ndërkombëtare, përfaqësues të zyrave të huaja diplomatike në Kosovë në mesin e të cilëve edhe shefja e Zyrës Amerikane znj.Marsi Ris, shefi i Zyrës Britaneze, ai i Zyrës Gjermane etj.



Në këtë përvjetor, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, z.Lutfi Haziri duke përshëndetur të pranishmit e shumtë, pohoi se, Asociacioni i Komunave i themeluar para tri viteve si përvojë e re për Kosovën ishte një bashkim që arriti të forcojë bashkëpunime të grupeve të ndryshme etnike dhe partiake.

"Duke u përballë me sfida të ndryshme kemi ecur me institucionet më të larta dhe pjesëmarrja jonë në vendet e Evropës Juglindore dhe bashkëpunimet me qytete të ndryshme të evropiane e botërore dëshmon për punën dhe suksesin e Asociacionit të Komunave të Kosovës" – tha kryetari Haziri. Ai shtoi se "kemi arritur të ngrisim kapacitetet e bashkëpunimit mes grupeve të ndryshme politike, brenda një komune si dhe kapacitetet e bashkëpunimit në mes të komunave të ndryshme dhe nga grupet etnike" për të paraqitur më tutje synimin për vazhdimin e këtij suksesi edhe në të ardhmen. "Bashkëpunim do të kemi edhe në të ardhmen kurse si ekip i përbashkët do të koprojmë edhe me komunat në region, Evropë dhe ShBA".

Në emër të presidentit të vendit dr.Ibrahim Rugova, këshilltari i tij z.Halit Muharremi shprehu kënaqësinë që sot është mes përfaqësuesve të komunave duke e vlerësuar lartë punën e pushtetit lokal e njëkohësisht edhe si punë të vështirë sepse pushteti lokal është i pari që ballafaqohen me problemet e qytetarëve.

Duke përshëndetur në emër të Qeverisë së Kosovës ministri z.Bexhet Brajshori tha se "është kënaqësi perosnale që në emër të Qeverisë të përshëndes këtë përvjetor dhe përfaqësuesit e Komunave të Kosovës. Kjo është forma më e mirë e bashkëpunimit të forcave të pushteteve lokale për të ecur përpara në drejtim të asaj që e quajmë një funksionalitet më pozitiv, të funksionimit të pushteteve lokale".

Shefi i zyrës gjermane Peter Rondolf duke përshëndetur në emër të të gjitha Zyrave të Kuintit që veprojnë në Prishtinë tha se "demokracia më së miri vendoset në pushtetin lokal dhe qeveria është për popullin e jo populli për qeverinë, dhe populli i Kosovës do të dijë se a ka përparim apo jo në pushtetin lokal. Kjo më së miri do të vërehet me faktin se a do të ketë sukses apo jo kthimi, që varet nga pushtetet lokale dhe është një ndër standardet kryesore për Kosovën".



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti I, Nr. 5 - Korrik & Gusht 2004

Bordi Botues: Sazan Ibrahim, Arsim Osmani, Mexhit Shaqiri, Merita Krasniqi

Rr.Isa Kastrati, Nr.113 Tel&Fax: 038 / 245 - 734
komunat_akk@hotmail.com

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbështetet nga Agjensioni Evropian për Rindërtim përmes projektit "Përkrahje decentralizimit në nivelin komunal", implementuar nga IFES Ltd.



Statusin e Vëzhguesit

Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština

Anëtar i përhershëm